



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 23.02.2021, ora 10:10

Drejton mbledhjen:

Ilir Beqaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës

Shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 124/2015 “Për eficiencën e energjisë”, të ndryshuar””. *(Komision përgjegjës)*

Marrin pjesë:

Ilir Beqaj, Eglantina Gjermani, Andrea Marto, Tatiana Nurçe, Ilir Ndraxhi, Arben Pëllumbi, Robert Bitri, Klajdi Qama, Halit Valteri, Arlind Çaçani, Nimet Musaj, Zef Shtjefni dhe Ilir Pendavinji.

Mungojnë:

Lefter Koka, Dritan Bici, Gjetan Gjetani, Rrahman Rraja, Halil Jakimi dhe Besnik Baraj.

Të ftuar:

Gjergji Simaku – Zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë:

Laureta Dibra – Përgjegjëse Sektori në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Rudina Xhelilaj - Drejtoreshë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

HAPET MBLEDHJA

Ilir Beqaj - Mirëdita kolegë dhe kolege!

Fillojmë mbledhjen e komisionit datë 23 shkurt ora 10:10. Siç kemi rënë dakord, sot kalojmë në diskutimin nën për nën të projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.124/2016 “Për eficiencën e energjisë”, të ndryshuar”.

Fillimisht kemi një koment nga Komisioni i Integritit, i cili propozon që në fund të faqes së parë të shënohet propozimi i Komisionit të Integritit, i cili thotë: “Ky ligj është përafëruar pjesërisht me direktivën 2012/27/BE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 25 tetor 2012 “Për eficiencën e energjisë, që ndryshon direktivat 2009/125/KE dhe 2010/30/BE dhe që shfuqizon direktivat 2004/8/KE dhe 2006/32/KE”, e ndryshuar”. Numri CELEX 32012L0027, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr.315, datë 14.11.2012, fq.1-56.”.

Kush është dakord? Abstenim? Zoti Gjuzi, zoti Shtjefni dhe zoti Valteri. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Në nenin 1 kemi një sugjerim nga Komisioni i Integritit për të riformuluar pikën 31 “Agregatori”, gjithashtu, kemi edhe një sugjerim nga ERE për të riformuluar pikën 3.

Zoti Simaku, a i keni komentet e Komisionit të Integritit?

Gjergji Simaku - Ne ishim në Komisionin e Integritit dhe jemi në dijeni për propozimet.

Ilir Beqaj – A jeni dakord me propozimet e Komisionit të Integritit?

Gjergji Simaku - Po.

Ilir Beqaj – A keni informacion për propozimin e ERE-s për të riformuluar pikën 3?

Gjergji Simaku - Jo, nuk kemi informacion.

Ilir Beqaj – Atëherë, unë po lexoj propozimin e bërë nga ERE: “Klient fundor i madh i energjisë është një klient fundor, i cili, në bazë të të dhënave të një procesi auditimi rezulton se ka konsum vjetor të energjisë më të madh se 1 milion kilovat\orë energji ekuivalente në vit”. Pra, me sa kuptojmë ne, këtu janë shtuar fjalët fundor i madh”. Ju thoni: “konsumator i madh i energjisë”, ndërsa këta thonë: “klient fundor i madh”, pastaj pjesa tjetër është e njëjtë.

Gjergji Simaku - Edhe në direktivë është “konsumator i madh” dhe nuk ka të bëjë me klientin e madh apo të vogël. Klientë, në kuptimin e Entit Rregullator, janë klientët fundorë, që blejnë energji elektrike dhe gaz natyrorë. Ky është skofi i punës së Entit

Rregullator. Kështu që, Enti Rregullator nuk mund të thotë: “Klient i madh dhe i vogël”, sepse këtu nuk kemi të bëjmë me konsumatorë. Jo çdo konsumator është klient, sepse nuk mund të jetë vetëm i energjisë elektrike, në kuptimin e Entit, pasi për të konsumuar ai blen dru zjarri, gaz të lëngshëm, naftë e të tjerë. Pra, së pari, në kuptimin e gjerë të energjisë, ne shikojmë konsumatorët e energjisë.

Së dyti, për sa i përket fjalës “ekuivalent”, me këtë fjalë mund të parashikojmë një konsumator, i cili, në kuptimin e Entit Rregullator, është thjesht për energjinë elektrike dhe gazin natyror, pra të Entit Rregullator të Energjisë, ndërsa në konceptin tonë, si klient i madh ekuivalent, ne e sqaruar në një seancë më parë, ku kemi thënë se e hoqëm fjalën “ekuivalent”, për shkak se ne nuk jemi në gjendje, si agjenci efience apo si ministri, që të evidentojmë konsumatorët e mëdhenj. Në ligjin e mëparshëm kishim 3 milionë kilovat/orë ekuivalent, ndërsa në këtë ndryshim ne kemi vënë 1 milion kilovat/orë energji elektrike. Energjia elektrike është e përdorur kudo dhe mjafton të jesh me 1 milion kilovat/orë konsumator i energjisë elektrike dhe automatikisht je konsumator i madh. Po të fusim fjalën “ekuivalente” do të jemi po në atë histori siç kemi qenë në ligjin e mëparshëm, ku nuk arrinim të identifikonim kush ishin këta me konsum ekuivalent, ku përfshiheshin, përveç energjisë elektrike, edhe energjitë e tjera, siç ishte nafta, gazi i lëngshëm, drutë e zjarrit, energjia diellore e të tjera. Ky ka qenë diskutimi ynë dhe mendoj se kemi të drejtë, për shkak se ata i nënshtrohen një skeme detyruese. Duke vendosur para skemës detyruese një situatë të tillë ekuivalente, atëherë klientët do të na shpëtojnë, në kuptimin energjisë në përgjithësi dhe energjisë elektrike në veçanti.

Faleminderit!

Ilir Beqaj - Ne kemi disa pyetje.

Te pika 4 e nenit 1 të projektligjit, që shton pikën 22/1 “Organet e qeverisjes qendrore janë të gjitha drejtoritë administrative”. “Drejtoritë administrative” është një togfjalësh që nuk është shumë prezent në praktikën e legjislacionit tonë. Çfarë keni parasyshtuar ju me këtë term?

Gjergji Simaku - Këtë nocion e ka direktiva dhe për ne është e rëndësishme ajo që vjen më mbrapa. Pra, cilët janë konsumatorët e mëdhenj dhe cilët futën në skemat obligative kur bëhej fjalë për rinovimin e ndërtesave publike. Ndërtesat publike janë ndërtesat në pronësi të organeve të qeverisjes vendore dhe këtu mbarojnë ndërtesat publike në konceptin e direktivës, ndërsa në konceptin tonë ndërtesat publike janë shtuar si target grup, pra janë bërë edhe ndërtesat e qeverisjes lokale dhe të gjitha ndërtesa që janë nën administrimin e shtetit, që paguhen nga taksat e shtetit. Kjo pjesë e qeverisjes vendore futet pikërisht te ky lloj

rinovimi, pra kur thuhet: “Ndërtesat që janë nën administrimin e organeve të qeverisjes qendrore”. Në organet e qeverisjes vendore janë të gjitha organet që kanë të bëjnë vetëm me godinën ose ndërtesën e ministrive. Kjo pjesë është e vogël për të krijuar një strategji të ardhshme të rinovimit të ndërtesave, prandaj dhe ne kemi vendosur me ligj që në qeverisjen vendore do të kemi 3% të rinovimit të tyre në vit dhe për të tjerat e kemi vendosur 2% në vit për rinovimin e tyre me konceptet eficiencës së energjisë. Ky ka qenë diskutimi, prandaj është futur edhe shprehja: “Organet e qeverisë vendore”, por, sipas mendimit tim, nuk jep ndonjë...

Ilir Beqaj - Unë kërkoj shpjegim për shprehjen “Drejtoritë administrative”. Çfarë keni parasysh me këtë togfjalësh?

Gjergji Simaku - Me drejtoritë administrative qeverisjet qendrore janë edhe drejtoritë e tyre administrative, të cilat nuk mund të jenë brenda ndërtesës qendrore, brenda ministrisë, por mund të jenë diku tjetër, siç është Agjencia e Eficiencës së Energjisë, e cila varet drejtpërdrejtë nga Ministria. Këto futen në ndërtesat e qeverisjes qendrore, por është e vendosur diku tjetër në adresën e vet.

Ilir Beqaj - Ne, si komision, kemi këtë propozim: ligji 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” përcakton këto organe administrative: Kryeministrinë, ministritë, institucionet e varësisë, degët territoriale, agjencitë autonome, administrata e prefektit dhe njësitë e drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve. Këtu nuk është Kuvendi, Presidenti apo institucionet e sistemit të drejtësisë, kështu që na duhet të gjejmë një zgjidhje. Ne mund të themi që janë të gjitha ato sipas ligjit nr. 90/2012, por që lëmë jashtë të gjitha godinat e sistemit të drejtësisë, të cilat duhet të rinovohen.

Gjergji Simaku - Të them të drejtën ky është një defekt i konsulencës, që na është bërë për këtë çështje dhe unë ndodhem para një gjëje të tillë. Mund ta riformulojmë ashtu siç e mendoni ju, në mënyrë që në qendroren të jenë edhe këto që ju përmendet.

Ilir Beqaj – Për momentin e lëmë këtë dhe gjejmë një togfjalësh për ta bërë sa më gjithëpërfshirës, por që ideja juaj është të futet çdo godinë e institucioneve qendrore dhe varësitë e tyre, apo jo?!

Gjergji Simaku - Po.

Ilir Beqaj - Në pikën 5 “Rinovim i konsiderueshëm” ka kuptimin, siç përkufizohet në pikën 22 të nenit 3 të ligjit nr.116/2016, “Për performancën e energjisë në ndërtesa”, të ndryshuar.”. Ne sugjerojmë: “Rinovim i konsiderueshëm është rinovimi i një ndërtese, ku më shumë se 25% e sipërfaqes së ndërtimit të ndërtesës i nënshtrohet rinovimit, që nënkupton ndërhyrjen nëpërmjet rikonstruksionit dhe/ose rikonstruktimit në mbështjelljen e jashtme dhe

në sistemin teknik të ndërtesës, sipas përcaktimeve të legjislacionit “Për performancën e energjisë në ndërtesa”.

Gjergji Simaku- Dakord. Ajo është definuar në atë ligj dhe kjo pikë mund të hiqet fare, sepse kemi referenca të kësaj natyre.

Ilir Beqaj - Kemi një problem. Ju thoni: “Rinovim i konsiderueshëm”, por ligji bazë thotë: “I rëndësishëm” dhe, meqenëse këto dy fjalë janë të ndryshme, edhe pse ju mund të keni parasysh të njëjtën gjë, ne e kemi risjellë në mënyrë të shtjelluar riformulimin.

Gjergji Simaku - Dakord.

Ilir Beqaj - Atëherë, hedhim në votë nenin 1 të projektligjit, duke mos marrë parasysh sugjerimin e ERE-s për formulimin e “Klientit fundor” dhe duke marrë parasysh sugjerimin e Komisionit të Integritetit për “Agregatorin”, sugjerimin e komisionit tonë për “Rinovim të konsiderueshëm” dhe duke rënë dakord që deri në zbardhje për “Drejtoritë administrative” do të gjejmë një shprehje më përfshirëse. Kush është dakord? Abstenim? Zoti Gjuzi dhe zoti Shtjefni. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Abstenim? Zoti Gjuzi dhe zoti Shtjefni. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 3. Kemi një pyetje të germa “k” për ministrinë. Çfarë keni parasysh me shprehjen: “Stok kombëtar i ndërtesave”, mos duhet të përkufizohet?

Gjergji Simaku- Në definicionin tonë dhe në definicionet e huaja kemi një stok ndërtesash, që ndahet në ndërtesa publike dhe në ndërtesa rezidenciale, të cilat quhen banesa...

Ilir Beqaj - Ne kemi problemin e “Stokut”, sepse për “Banesat” jemi të qartë.

Gjergji Simaku - Stoku kombëtar i ndërtesave përfshin të gjitha ndërtesat, qofshin banesa...

Ilir Beqaj- Mos duhet ta shtojmë te neni i përkufizimeve?!

Gjergji Simaku- Po, mund ta shtojmë te neni i përkufizimeve “Stoku i ndërtesave” dhe po bëj gati një definicion.

Ilir Beqaj- Po, por a mund t’i kthehemi nenit pasi kemi votuar?

Xhilda Pinci - Po, mund t’i kthehemi.

Ilir Beqaj - Dakord.

Kujtim Gjuzi - Kryetar, ju lutem!

Ilir Beqaj - Nuk e kam mbaruar fjalën.

Kujtim Gjuzi - Keni shkelur procedurën, sapo e shkelët.

Ilir Beqaj - A ka mundësi ta mbaroj fjalën, ju lutem!

Kujtim Gjuzi - Kaluat atë që sapo thatë pa votim.

Ilir Beqaj - A ka mundësi ta mbaroj fjalinë?

Kërkoj të hedhim në votim nenin 3, me rënien dakord që në nenin 1 do të kthehem të shtojmë propozimin e “Stokut”.

Zoti Gjuzi, fjala për ju.

Kujtim Gjuzi- Faleminderit, zoti kryetar!

Mendova se e vendosët me veto, por tani që e mbaruat fjalën jam dakord.

Ilir Beqaj - E hedhim në votim kush është dakord? Abstenim? Zoti Gjuzi dhe zoti Shtjefni. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 4. Teknikë legjislative, sepse neni 4 thotë: “Agjencia përgjegjëse për licencën e energjisë publikon në faqen zyrtare rregullisht të gjitha raportet, të gjitha veprimtarit e monitorimit e të tjera. Miratohet nga Këshilli i Ministrave në përputhje me...”. Fjala “miratohet” të hiqet?

Xhilda Pinci – “E miratuar”, sepse është një bazë e centralizuar të dhënash, e cila shërben...

Pastaj është fjalia tjetër.

Ilir Beqaj – Pra, e dyta duhet hequr?

Xhilda Pinci – Duhet hequr “e miratuar”, sepse është në fund te platforma...

Ilir Beqaj – Atëherë, e hedhim në votë nenin 4 me propozimin e komisionit tonë që te fjalia “e cila është një bazë centralizuar të dhënash e miratuar” fjala “e miratuar” nuk duhet, sepse në fund fare themi “miratohet nga Këshilli i Ministrave”.

Kush është dakord? Abstenim? Zoti Gjuzi dhe zoti Shtjefni. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 5. Komisioni i Integritetit ka bërë një riformulim për pikën 1. Zoti Simaku, besoj se ju jeni njohur me të?

Gjergji Simaku – Po.

Ilir Beqaj – Atëherë, në pikën 1 ne ju pyesim: çfarë keni parasysh me autoritet të prokurimit publik?

Gjergji Simaku – Me autoritet të prokurimit publik kemi parasysh autoritetet kontraktore.

Ilir Beqaj – Pra, çdo ent prokurues, sepse autoritet i prokurimit publik është Agjencia e Prokurimit Publik në Shqipëri ose të themi të autoriteteve?

Gjergji Simaku – Të autoriteteve kontraktuese, nëse kjo është te ligji për prokurimin.

Ilir Beqaj – Në legjislacionin e prokurimit përdoret “ent prokurues” ose “autoritet kontraktues”.

Gjergji Simaku – “Autoritet kontraktues” është më i qartë.

Ilir Beqaj – Në rregull.

Atëherë, Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për Energjinë... Problemi është se në fjalinë e parë kemi këtë problem, zoti Simaku: “Iniciativën për të propozuar në Këshillin e Ministrave e kanë vetëm anëtarët e kabinetit. Agjencia e Prokurimit Publik nuk mund të ndërmarrë iniciativën të jetë bashkëpropozuse me një ministër të caktuar.

Përgjithësisht, me aq sa e kam parë, në legjislacionin aktual të prokurimit publik çdo propozim që bëhet atje shkon me propozim të Kryeministrit. Mënyra se si funksionon Këshilli i Ministrave ka një ligj të veçantë. Unë mendoj se ne duhet të themi “më propozim të ministrit përgjegjës për Energjinë”, i cili vetvetiu konsultohet me Agjencinë Prokurimeve dhe e di detyrën e tij.

Gjergji Simaku – Dakord.

Ilir Beqaj – Ndërsa për sugjerimin, ose atë që thoni ju se përfshirja në rregullat e prokurimit të produkteve dhe shërbimeve, që kanë nivel të lartë energjie, duhet të kuptojnë mos ndoshta kjo fillon e ndikon në ngushtimin e konkurrencës?

Gjergji Simaku – Ky është një diskutim i gjatë dhe shumë i rëndësishëm. Normalisht ne jemi penguar për këtë çështje në lidhje me llambat, pra me sistemet e ndriçimit, ku autoritete kontraktore kontraktojnë me çmimin më të ulët. Ndërkohë që këtu duhet bërë një krahasim për eficiencën e energjisë dhe nuk është e thënë që produkti me çmim më të ulët të ketë eficiencën më të lartë, diçka që nuk ndodh. Gjithsesi, në këtë ligj ne kemi pasur presion edhe nga sekretariati që ta vendosim këtë çështje, për arsye sepse ka shumë produkte që konsumojnë energji të cilat për autoritetet publike duhet të blihen vetëm me eficiencë të lartë. Për shembull, ju e dini për kondicionerët, në qoftë se Kuvendi do të blinte 300 apo 400 kondicionerë, atëherë me siguri këtu shfaqet një mjedis ku konsumi i energjisë mund të rritet në mënyrë të menjëhershme. Atëherë, masa merret që në prokurim, pra që vendosen klasa të tilla energjie, të cilat, megjithëse mund të rezultojnë më të shtrenjta, në raport me konsumin energjisë që mund të ketë kjo pajisje ndër vite, konsiderohen të lira. Kjo analizë i përket pikërisht autoritetit ta vendosë në specifikën...

Ilir Beqaj – Cilat autoritete keni parasysh në këtë rast?

Gjergji Simaku – Autoritetet kontraktore.

Ky është thelbi i diskutimit

Ilir Beqaj – Propozimi ynë është ky: “Këshilli i Ministrave me propozim...”. Kini parasysh që kemi një riformulim të Komisionit të Integritetit, me të cilin ju keni rënë dakord.

Zoti Simaku, ne kemi vetëm këtë koment. Nuk mund të marrë iniciativë propozuese Agjencia e Prokurimit Publik. Kështu që ta heqim këtë e të themi” “ministri përgjegjës për Energjinë”.

Gjergji Simaku – Dakord.

Ilir Beqaj – E hedhim në votë. Pra, marrin për bazë riformulimin e Komisionit të Integritetit, duke hequr këtë që sapo thamë.

Kush është dakord? Abstenim? Zoti Shtjefni. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Pika 2, zoti Simaku, nuk e di në cilën kohë e keni përgatitur projektligjin, por së fundi kemi pasur ndryshime në ligjin e prokurimit publik.

Gjergji Simaku – Është përgatitur para 2 vjetësh.

Ilir Beqaj – Kam përshtypjen se këtu duhet të ndalojmë pak për t’u konsultuar me legjislacionin e ndryshuar të prokurimit publik.

Gjergji Simaku – Dakord.

Ilir Beqaj – Dakord, po si do ta ndajmë detyrën? E caktojmë në fund të mbledhjes.

Atëherë, nuk e votojmë nenin.

Kalojmë te neni 6.

Në pikën 2 ne themi që fjalët “ministrinë e linjës” të zëvendësohen “me Ministrinë përgjegjëse për Energjinë”.

Në pikën 3 kemi një pyetje. Ky afati 6-mujor mos është shumë i ngushtë, që i keni lënë vetes për planin vendor? Kini parasysh që duhet t’i bëjnë edhe bashkitë.

Gjergji Simaku – Ju e mbani mend që ne kemi pasur diskutim dhe unë kam thënë për këtë pjesë që ne kemi plane qendrore dhe plane vendore. Planet vendore janë në direktivë. Ne nuk mund ta shkëpusim planin vendor nga plani qendror i eficiencës.

Ilir Beqaj – Jo, mos është shumë i ngushtë afati 6 muaj?

Gjergji Simaku – Është shumë i ngushtë afati dhe mendoj se nuk duhet të ketë afat. Jo më vonë se 1 vit, sepse planet në eficiencë tani janë 10-vjeçare.

Ilir Beqaj – Pra, jo më vonë se 12 muaj.

Pra, në qoftë se i lëmë 12 muaj, e shtyjmë për vitin e ardhshëm dhe nuk prekim buxhetin e këtij viti.

Në pikën 2 Instituti për Politikat Mjedisore ka bërë sugjerimin që të përfshihet edhe shoqëria civile në diskutimet para miratimit në këshillin bashkiak.

Zoti Simaku, a keni ndonjë koment për këtë?

Gjergji Simaku – Nuk kam koment për këtë, por gjykoj se ky proces përmes këshillave bashkiakë të planeve të veprimit për secilin, duke zbërthyer planin e madh të eficientës të energjisë, do të jetë një punë e jashtëzakonshme dhe do ta zgjojë pushtetin vendor. Nuk kam komente. Le të marrë pjesë kush të dojë në këtë pjesë.

Ilir Beqaj – Dakord.

Mua nuk më pëlqen “shoqëria civile e fushës”, “shoqëria civile”, ose “grupe interesi”.

Atëherë, ndryshojmë pikën 2 dhe themi “jo ministritë e linjës”, por “Ministria përgjegjëse për Energjinë, agjencia përgjegjëse për eficientën, grupet e interesit, përfaqësuesit e shoqërisë civile” dhe e vazhdojmë pikën 2.

Ndërsa në pikën 3 pika 6 bëhet pika 12. Kush është dakord? Abstenim? Zoti Shtjefni. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Te pika 9/2 kam një pyetje, zoti Simaku. Ju në pikën 1 thoni: “Këto masa zbatohen nga subjektet publike private përgjegjëse”. Çfarë keni parasysh me këtë?

Gjergji Simaku – Masat për eficientë të energjisë kanë një objektiv të qartë, të cilat janë detyruese.

Ilir Beqaj – Cilat janë subjektet private përgjegjëse?

Gjergji Simaku – Së pari, subjektet publike dhe subjektet private përgjegjëse janë pikërisht konsumatorët e mëdhenj.

Ilir Beqaj – Atëherë, cilët quani konsumator të mëdhenj?

Gjergji Simaku – Nuk ka tjetër. Subjektet publike janë, por në subjektet private prekim konsumatorët që e kanë detyrim, pra konsumatorët e mëdhenj. Po ta mbani mend ju, ky definicion ka zbritur, për shkak sepse në pjesën private kemi edhe konsumatorë që, për shkak të rinovimit të kërkesës së tyre, janë detyruar t’i zbatojnë masat. Këto masa duhet t’i zbatojnë kështu siç thuhet këtu, pra që janë masa sektoriale. Megjithëse nuk është në grupin detyrues, ka detyrimin t’i bëjë këto masa, për shkak se bën rinovimin e ndërtesës. Me këtë fjalë është pasur parasysh pikërisht ky moment, por, për mendimin tonë, këto masa zbatohen

për subjektet publike dhe ato private ose konsumatorët e mëdhenj, sepse janë përsëri publike dhe private, prandaj e kemi lënë fjalën “përgjegjëse”, sepse i përfshin të gjitha.

Ilir Beqaj – Pse të mos themi konsumatorët e mëdhenj?

Gjergji Simaku – Sepse do të kufizojmë të vegjlit.

Ilir Beqaj – Ligji detyron.

Gjergji Simaku – Të vegjlit i detyron vetëm për një moment të caktuar, kur një konsumator i vogël, që nuk ka një milion kilovat/orë në vit merr dhe rinovon ndërtesën e tij, tani ky, meqenëse e mori detyrimin për eficiencën, ne duhet ta lëmë jashtë këtyre definicioneve që janë shumë të qarta dhe përfshijnë masa sektoriale. Ai e ndërmerri iniciativën edhe nëse nuk është i madh. Prandaj është kjo çështje, por edhe mund ta lëmë te konsumatorët e mëdhenj. Ligji ka frymën që t’i përfshijë të gjithë konsumatorët.

Ilir Beqaj – Edhe një herë, ligji ka frymën, por ka edhe detyrime dhe, kur themi këto masa zbatohen, po nuk i zbatove, ke disa penalitete.

Gjergji Simaku – Ta lëmë shprehjen “nga konsumatorët dhe subjektet publike, konsumatorët e mëdhenj dhe subjektet që përfshihen në detyrimet për eficiencën e energjisë”.

Ilir Beqaj – Ne mund të themi: “Këto masa zbatohen nga subjektet publike e private që detyrohen për eficiencën energjisë”.

Gjergji Simaku – Dakord.

Ilir Beqaj – “Detyrimet për eficiencën energjisë dhe përfshin” e të tjera. Dakord.

Gjergji Simaku – Dakord.

Ilir Beqaj – Te germa “c” kemi një propozim nga vetë prodhuesit, të cilët thonë këtë riformulim: “Sistemeve energjetike të matjes, të tilla si pajisjet vizuale të matjes, matësve me dy drejtime për vetëprodhimin e energjisë nga burime të rinovueshme, sistemeve të matjeve të menaxhuara nga larg dhe sistemet informuese të faturimit”.

Gjergji Simaku – Personalisht jam dakord nëse më pyet, sepse...

Ilir Beqaj – Nuk e kuptova, jeni apo nuk jeni dakord?

Gjergji Simaku – Jam plotësisht dakord.

Ilir Beqaj – Atëherë, e hedhim në votim nenin 9/2, duke vënë fjalinë e fundit të pikës 1: “Këta matës zbatohen në subjektet publike dhe private që detyrohen për eficiencën e energjisë...” dhe në pikën “c” “marrim për bazë informimin e shoqatës së vetëprodhuesve”.

Urdhëroni, zoti Pëllumbi!

Arben Pëllumbi – Në pikën “a” ne kemi miratimin e standardeve dhe normave, më duket një terminologji shumë e përgjithshme, sepse ne mund ta përkufizojmë atë dhe të themi “ato që janë miratuar nga Agjencia e Eficiencës së Energjisë”.

Ilir Beqaj – Ju thoni që kështu është shumë e hapur?

Arben Pëllumbi – Duket sikur standardet dhe norma janë të përgjithshme si terma dhe këtu bëhet fjalë për një gjë specifike, standarde dhe normat të aprovuara nga Agjencia e Eficiencës së Energjisë.

Ilir Beqaj – Zoti Simaku?

Gjergji Simaku – Zoti Pëllumbi, ka të drejtë, duke thënë: “Standarde dhe norma të miratuara që synojnë”, domethënë është thjesht një...

Ilir Beqaj – Të miratuara nga?

Gjergji Simaku – Të miratuara.

Ilir Beqaj – Unë shtoj edhe...

Gjergji Simaku – Tani, standardi është...

Ilir Beqaj – Nga kush: nga Agjencia, nga ministria, nga Këshilli i Ministrave?

Gjergji Simaku – Agjencia për Eficiencën e Energjisë nuk është subjekt që miraton norma dhe standarde.

Ilir Beqaj – Kush i miraton ato?

Gjergji Simaku – Normat dhe standardet miratohen në një nivel tjetër, të cilat lidhen me metodologji, me standarde dhe kështu me radhë, por nuk është organ që miraton norma dhe standarde. Pra, kemi një drejtor standardesh që miraton standardet e aplikueshme për Shqipërinë dhe norma, të cilat janë vendosur në kërkesat minimale të performancës së energjisë së ndërtesave e kështu me radhë. Pra, normat përgjithësisht vendosen me kërkesë...

Ilir Beqaj – Atëherë, mund ta themi kështu: “Miratimi i standardeve dhe normave të...”

Gjergji Simaku – Të miratuara.

Ilir Beqaj – Por “miratimi” dhe “të miratuara” nuk shkon.

Gjergji Simaku – Jo, jo, ndër të tjera “Standarde dhe norma të miratuara që synojnë”.

Ilir Beqaj – E pra.

Gjergji Simaku – Fjala “miratim” të kalohet “të miratuara”.

Ilir Beqaj – “Standarde dhe norma të miratuara nga autoritetet përgjegjëse për eficiencën e energjisë”, duke thënë: “Autoritetet përgjegjës mund të jetë edhe agjencia, edhe ministria...”

Gjergji Simaku – Po, dakord, edhe kështu mund ta bëjmë: “Autoritetet përgjegjëse për eficiencën e energjisë”, por “autoritetet përgjegjëse për energjinë” do të ishte më mirë.

Ilir Beqaj – Për energjinë, dakord, që synojnë përmirësimin e eficiencës. Dakord.

Atëherë, me këto tri ndryshime e hedhim në votë nenin...

Arben Pëllumbi – Kryetar, kam edhe një pikë tjetër.

Ilir Beqaj – Një minutë, të lutem.

Arben Pëllumbi – Në shkronjën “d” në fund të fjalisë thuhet: “dhe sidomos të CO2-shit”.

Ilir Beqaj – Po.

Arben Pëllumbi – Në fakt, ndoshta do të ishte më mirë të thotë: të gazrave serrë, sepse nuk është vetëm CO2-shi.

Ilir Beqaj – Zoti Simaku?

Gjergji Simaku – Absolutisht, ka të drejtë dhe në vendin tonë nuk është thjesht CO2-shi, por edhe gazet floro-hidrokarbure që kanë të bëjnë me sistemet e kondicionimit. Këtu kemi të drejtë.

Ilir Beqaj – Gazeve serrë?

Gjergji Simaku – Gazeve serrë ose gazeve GHG.

Ilir Beqaj – Kam edhe unë tani kështu një gjë të vogël: a mund ta heq fjalën “sidomos”, se kjo është një gjë që...

Gjergji Simaku – Unë them që më mirë ta lëmë fjalën “sidomos”, sepse çdo projekt që vjen në Shqipëri shikohet përballë dyoksidit të karbonit.

Ilir Beqaj – Dakord, zoti Simaku, por po të themi...Jo, nuk më pëlqen fjala “sidomos”, themi “veçanërisht”, “specifikisht”.

Gjergji Simaku – Po, mirë, “veçanërisht” ndoshta.

Ilir Beqaj – Dakord.

Gjergji Simaku – Por CO2-shi është një matës që reflekton efikasitetin, domethënë sa CO2 ke kursyer, nëse ke aplikuar masën?

Ilir Beqaj – Kaluam nga CO2-shi te gazet serrë, kështu thamë, apo jo.

Gjergji Simaku – Po, te gazet serrë, dakord.

Ilir Beqaj – Atëherë, hedhim në votë nenin 9/2. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Gjuzi, Shtjefni.

Miratohet.

Neni 3.

(Ndërhyrje nga këshilltarja.)

Vetë prodhuesit shtojnë shkronjën “e”. Unë kam fillimisht një problem me datën 1.09.2021. Unë besoj se duhet ta kalojmë këtë vit, sepse buxheti është miratuar.

Zoti Simaku, më ndiqni?

Gjergji Simaku – Po ju ndjek, por ku është 2021-shi këtu?

Po, shtator 2021.

Ilir Beqaj – Që në pikën 1 e thotë. Buxheti i vitit është miratuar.

Gjergji Simaku – Atëherë, do ta lëmë për vitin 2022.

Ilir Beqaj – Dakord, data bëhet 01.09.2022.

Gjergji Simaku – Jo i nënti, mund ta bëjmë i treti, i katërti i vitit 2022.

Ilir Beqaj – I katërti, atëherë.

Gjergji Simaku – Që të reflektojmë planet e PBA-së për këtë vit.

(Ndërhyrje nga këshilltarja.)

Ilir Beqaj – Më fal, jemi te neni 9/3.

Te neni 9/3, pika 1, ka një propozim që të shtohet shkronja “e”, e cila thotë kështu: “Përfshirjes në rinovim të ndërtesave të stokut kombëtar të sistemit të prodhimit të energjisë nga burime të rinovueshme për vetëkonsumin, sipas parashikimeve të ligjit nr. 7/2017, të ndryshuar””.

Gjergji Simaku – Mendoj se është kapur jashtëzakonisht mirë dhe për të rinovuar ndërtesat, futja e një prodhuesi brenda, siç është prodhimi nga fotovoltaikët, shkon ekskluzivisht në drejtim të kundërt të bilancit të konsumit.

Pra, unë jam dakord 100%. Madje, ju përgëzoj!

Ilir Beqaj – Dakord.

Gjergji Simaku – Është i vetmi që e parashikon.

Ilir Beqaj – Hedhim në votë nenin 9/3, duke shtuar shkronjën “e” sipas propozimit të shoqatës, por duke thënë: “sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi” në fund të fjalisë. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Shtjefni.

Miratohet.

Kalojmë te neni 9/4. Në fakt, vazhdojmë të jemi te neni 6, se po e quajmë 9/4, por ndryshimet e 9/4-ës... Na ka ardhur, së pari, një sugjerim nga Komisioni i Integritetit Europian, zoti Simaku, i cili na thotë që propozimi juaj 2%, në fakt, duhet të jetë 3%, sepse kështu e ka direktiva.

Gjergji Simaku – Po.

Ilir Beqaj – Por ata propozojnë këtë gjë: “3% të organeve në pronësi të zëna nga organet e qeverisjes qendrore dhe 2% bizneset e tjera publike”.

Gjergji Simaku – Po.

Ilir Beqaj – Jeni dakord?

Gjergji Simaku – Jemi dakord.

Ilir Beqaj –Atëherë, marrim për bazë ndryshimin e Komisionit të Integritit, por datën 01.09.2021 e bëjmë 01.04.2022.

Gjergji Simaku – Po.

Ilir Beqaj –Kjo është në rregull. Te 4/1-shi kemi edhe një propozim që vjen nga ASP-ja. Në pikën 1 shprehja “siguron se” të zëvendësohet me “ngarkohet me zbatimin”.

Gjergji Simaku – Dakord.

Ilir Beqaj – Dakord edhe me këtë.

Eglantina Gjermeni – Zoti kryetar, kam një pyetje.

Ilir Beqaj – Ja, një sekondë, të lutem!

“Detyrohet”, jo ngarkohet, “siguron se”, se ngarkohet...

Urdhëroni, zonja Gjermeni.

Eglantina Gjermeni – Faleminderit, kryetar!

Lidhur me nenin 9/4, meqenëse bëme ndryshimin e datës, nga 1.09.2021, e shtymë në mars të vitit të ardhshëm dhe, gjithashtu, rritëm edhe përqindjen 3% të sipërfaqes totale të ndërtesave publike...

Ilir Beqaj – Sepse aq e ka direktiva, por jo të gjitha publikeve; të zyrave qendrore e lamë.

Eglantina Gjermeni – E drejtë, por a e garantojmë dot ne, a kemi mundësi? Se me këtë projektligj që kemi sjellë, ne heqim fondin që e kishim krijuar me kaq vërtet përkushtim në fillim, duke menduar që do të ndihmonte. A kemi garanci ne që ky 3% realizohet vitin tjetër në buxhet? Se tani ky projektligj qenka hartuar dy vjet më parë; para tërmetit, para pandemisë... Në qoftë se e vëmë në ligj, duhet të jemi të sigurt që kemi mundësi ta realizojmë atë.

Ilir Beqaj – Zonja Gjermeni, keni shumë të drejtë.

Eglantina Gjermeni – Unë jam skeptike dhe do të doja të dija mendimin e ministrisë.

Ilir Beqaj – Keni shumë të drejtë...

Eglantina Gjermeni – Faleminderit!

Ilir Beqaj – Por problemi është ky që ne rrugën e integritit e kemi pa kthim. Për sa kohë përafrojmë legjisllacion, do të duhet ta ndjekim integrimin. Ne ose mund ta shtyjmë datën e fillimit të zbatimit, por këtu nuk mund të ndryshojmë...

Ne nuk mund të miratojmë diçka që bie ndesh me çfarë thotë direktiva, apo jo.

Eglantina Gjermeni – Jam dakord, por për datën...

Ilir Beqaj – Sigurisht, nuk kemi ditur gjë për pandeminë, por tani qeveria na e ka sjellë me 2021, ne po ia shtyjme qeverisë. Çfarë të them unë?! Por ne le t'ia vëmë objektivin qeverisë. Në qoftë se kjo e fundit pastaj nuk do të jetë në gjendje ta zbatojë, le të vijë të na thotë: kërkoj një datë tjetër. Unë këtë sugjeroj, sepse, në fakt, po nuk vumë afatet, praktikisht atëherë i bie që edhe ligjin vetë ta shtyjme krejt për të bërë miratimin. Kështu që unë them të vazhdojmë. Pastaj, kur të vijmë te votimi në tërësi, bëjmë një vlerësim më të përgjithshëm.

Zoti Simaku.

Gjergji Simaku – Atëherë, mund të thuhet “përgatit dhe publikon”.

Ilir Beqaj – Po, “përgatit dhe publikon”.

Gjergji Simaku – Praktikisht, ne e kemi përgatitur dhe mund ta publikojmë. Kjo lidhet me diskutimin e zonjës Gjermani dhe unë e përshëndes, e cila vërtet ka merak se ne nuk do t'ia dalim. Është pikërisht ky moment që çdo ndërtesë publike, në momentin kur vjen dikush kryetar bashkie apo futet në zyrat e reja, fillon rikonstruksionin e menjëhershëm. Ky rikonstruksion duhet të shoqërohet me rinovimin e ndërtesës në themel, në fakt, bashkë me eficiencën e energjisë. Prandaj e kemi vënë dhe mund ta marrë nga ky fond për ta bërë një gjë të tillë, por, si të thuash, ka edhe të drejtën për të kërkuar fonde për çështje të rinovimit, pasi është brenda kërkesave të ligjit.

Laureta Dibra – Mundem?

Ilir Beqaj – Patjetër.

Laureta Dibra – Lidhur me fjalën “përcakton”, për mendimin tim, ose çfarë ne kemi pasur në mendje, ka qenë ideja që miraton. Domethënë, ministri e miraton inventarin dhe e publikon, pra jo thjesht e përgatit, por e miraton.

Ilir Beqaj – Dakord, e miraton atëherë. Në rregull. Dakord jemi edhe ne, thjesht fjala “përcakton” ishte pak si e pavend.

Atëherë, hedhim në votë nenin 9/4 me ato çfarë diskutuam për të ndryshuar, duke përfshirë edhe ndryshimin në pikën 4 “miraton”. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? 2 vota abstenim të deputetëve Gjuzi dhe Shtjefni.

Miratohet.

Kalojmë te neni 7. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Dy vota abstenim të deputetëve Gjuzi e Shtjefni.

Miratohet.

Neni 8. Në pikën 2 është shprehja “miraton një skemë detyruese”. Çfarë keni parasysht me këtë?

Gjergji Simaku – Skema detyruese...

Laureta, fol ti.

Ilir Beqaj – Urdhëroni.

Laureta Dibra – Atëherë, lidhur me skemën detyruese, është një lloj skeme e përdorur edhe në vendet e Bashkimit Europian për periudhën 2017-2020. Pavarësisht se *deadline*-i ose afatet në direktivë kanë përfunduar, edhe direktiva e re, që parashikon për ta shtyrë, për ta konsideruar të suksesshme, me këtë...*(nuk dëgjohet.)* që kanë furnizuesit me pakicë ose shpërndarësit me pakicë të energjisë për t'u futur në skemën detyruese. Çfarë do të thotë kjo? Që në planin kombëtar të eficiencës së energjisë ka një objektiv madhor kombëtar dhe ky objektiv do të ndahet për konsumatorët e mëdhenj, për furnizuesit e vegjël, për shpërndarësit e vegjël të energjisë, si dhe për të gjithë konsumatorët e tjerë, për shembull, industria e të tjerë.

Shpërndarësit me pakicë lidhen kryesisht me furnizuesit i kanë marrëdhëniet e tyre me konsumatorin fundor rezidencial ose me industrinë. Kjo do të thotë që, në qoftë se duhet të ketë një metodologji që do të kalkulohet sa për qind e objektivit madhor do t'u dedikohet konsumatorëve për ta zbatuar, ata detyrimin e tyre mund ta zbatojnë me masa të ndryshme alternative të tipit, për shembull, që mund t'i asistojë qoftë sektori rezidencial apo edhe me një asistencë me industrinë për të bërë një auditim energjetik, kur këtë e ofron vetë.

Të gjitha këto ndihma ose asistencë që këto do të japin te konsumatorët fundorë, do të përkthehet pastaj në kredite energjie për vetë furnizuesit e vegjël, të cilat janë ekuivalente pastaj me objektivin që ai arrin, si të thuash, përkthehet në objektivin që arrin. Sigurisht, kjo ka një metodologji kalkulimi. Prandaj është lënë si detyrë aty që të miratohet metodologjia me vendim të Këshillit të Ministrave. Pra, është një skemë e dedikuar kryesisht për furnizuesit e vegjël dhe shpërndarësit me pakicë të energjisë.

Ilir Beqaj – Kam një pyetje te pika 1, zoti Simaku.

Ne themi këtu që Këshilli i Ministrave miraton çdo 10 vjet objektivat e kursimeve, apo jo. Zoti Simaku, mos është shumë ky 10-vjeçar?

Laureta Dibra – Aktualisht...

Gjergji Simaku – Planet...

Laureta Dibra – Gjergji, më fal!

Aktualisht, ne jemi duke hartuar Planin e Integruar të Energjisë dhe të Klimës, që është për periudhën 2021-2030, prandaj kjo është një periudhë 10-vjeçare. Parashikohet objektivit madhor dhe pastaj kjo do të ndahet për secilin lloj konsumatori ose për secilën pale të detyruar në përqindjet e caktuara ku do të jetë. Pastaj ka raportime në çdo 3 vjet për të parë edhe ku jemi dhe si jemi, apo edhe për përditësime të planit.

Ilir Beqaj – E kuptova.

Te pika 3, zoti Simaku, unë besoj se pjesa e fundit e pikës: “Ky udhëzues përfshin a, b, c”, nuk ka pse të jetë këtu. Këto duhet t’i ketë udhëzimi.

Gjergji Simaku – Doni të thoni që i ka metodologjia për këtë çështje?

Ilir Beqaj – Po, le t’i miratojë ministri këto; nuk kanë pse të jenë në ligj.

Domethënë, ne i themi që për këtë qëllim ministri përcakton mënyrën e llogaritjes, e objektivit, të kursimeve me një udhëzim të tij.

Gjergji Simaku - Me një udhëzim të ministrit. Dakord.

Ilir Beqaj - Ku udhëzim i përfshin të gjitha: a, b, c, d, deri tek e-ja.

Gjergji Simaku – Po, i përkasin udhëzimit. Dakord.

Ilir Beqaj – Tjetra, edhe gjithë pika 4 është pjesë e udhëzimit, mendojmë ne.

Gjergji Simaku - Po.

Ilir Beqaj - Kështu që bëjmë një të re. Vëmë kornizën te pika 3 dhe pastaj pjesa tjetër udhëzimi, është udhëzim ministri. Dakord?

Gjergji Simaku - Po, dakord jam.

Ilir Beqaj – Pra, jemi dakord me faktin që, në pikën 3 nuk ka germa dhe gjithë pika 4 hiqet.

Kush është dakord? Abstenim? Besoj, Shtejfni, Gjuzi. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 9. Marrëveshjet vullnetare.

Arben Pëllumbi - Kryetar me leje?

Ilir Beqaj – Po, patjetër.

Arben Pëllumbi - Meqenëse ne i hoqëm këto dhe do t’i kalojmë me udhëzim, unë thjesht dua t’i bëj një sugjerim zotit Simaku, nëse jemi në momentin që impiantet termike me fuqi termi mbi 100 kw t’ju bëjmë një kontroll të detyrueshëm vjetor dhe një certifikim të tillë. A jemi në këtë momente për ta bërë këtë gjë, për ta futur pastaj në udhëzim përkatës? Dua thjesht një mendim të tijin për këtë punë.

Gjergji Simaku - Atëherë, lidhur me impiantet mbi 100 kw, këto mund të ndahen që janë për ndërtesat ose impiante mbi 100 kw për qëllime të tjera, për ngrohje, për ujë, pra për ndërtesat. Atëherë, ju keni të drejtë me këtë gjë dhe ne e kemi vendosur këtë në ligjin për performancën e energjisë së ndërtesës, ku audituesi energjetik, bën edhe rolin e verifikuesit Pra, ia kemi lënë atij të drejtën të vendosë këtë gjë.

Në atë ligj dhe në aktet nënligjore, përcaktohen qartë se kush bën verifikim e pajisjeve, jo vetëm të 100 kw, por edhe më poshtë akoma, kur ato gjenden në një ndërtesë.

Pra, ka një raport verifikimi. Në këtë kuptim, unë nuk mund të zgjatem këtu pa bërë ndryshime përkatëse. Ju keni të drejtë. Verifikuesit dhe audituesit duhet të jenë të ndarë si dy ekspertë, por në kushtet e Shqipërisë ne kemi pranuar që audituesi të jetë edhe verifikues.

Gjithashtu, në një nen më poshtë, ju do të shikoni që do të kemi auditues të proceseve industriale. Duke qenë kështu, janë këta auditues që do të jenë verifikuesit e ardhshëm të këtyre. Pra, edhe vetë legjislacioni nuk na ka lejuar, që të vendosim një gamë të gjerë ekspertësh, por i kemi përmbledhur tek audituesit. Ky ka qenë një diskutim kur kemi bërë ligjin për performancën e energjisë në ndërtesa, ku direktiva përkatëse e kërkonte të qartë audituesin më vete dhe verifikuesin më vete. Pra, verifikuesi që do të verifikonte cilësinë e impianteve, ishte diçka tjetër, krahasuar me audituesin. Nuk u lejua në atë kohë dhe ne e kemi lënë audituesin si verifikues, por në këtë ligj kemi shtuar, si të thuash, gamën e ngjarjeve, gamën e ekspertizës që do bëjë ai. Pikërisht, më poshtë, ju do të gjeni në nenin 17 se cilat ndryshime do e përcaktojnë këtë gjë. Deri atëherë, të vazhdojmë, ta lemë kështu siç është.

Ilir Beqaj – Atëherë, kalojmë te nenin 9. Marrëveshjet vullnetare.

Shqetësimi ynë është te shprehja “marrëveshje të dakordësuara”.

Zoti Simaku.

Gjergji Simaku – Cili është diskutimi?

Ilir Beqaj – Ta them unë. “Marrëveshjet vullnetare janë marrëveshje të dakordësuara”, thoni ju. Ndërsa, tek 2/d thoni: “Sanksionet në rast të mos- përmbushjes së detyrimeve dhe procedurat e zgjidhjes së kontratës”. Pra, diku themi “marrëveshje”, diku themi kontratë”.

Gjergji Simaku – Atëherë, marrëveshjet vullnetare, praktikisht, në mënyrën siç është shkruar këtu, kanë të bëjnë me ato që bën agjencia me subjektet publike, pra me subjekte që i përkasin shtetit, jo private. Marrëveshjet vullnetare, praktikisht lindin si rezultat i një marrëveshje të kontaktimit të performancës, mbështetur mbi kursime. Pra, janë marrëveshje, ku vetë agjencia do të japë, si të thuash, një model të marrëveshjes. Pra, të gjitha bashkitë, komunat do të kenë një marrëveshje me të cilën ato do të bëjnë marrëveshje të posaçme.

Për shembull, për sistemin e ndriçimit, për sistemin e ujësjellësve, të cilat kanë të bëjnë pikërisht me kursimin e energjisë në përgjithësi dhe marrëveshjet vullnetare në kuptimin e direktivës, janë marrëveshje, janë modele të njohura të mbështetura mbi programin e eficiencës. Pra, kur themi për një bashki që do t’i nënshtrohet një skeme detyruese, për të kursyer medoemos një sasi energjie, sipas planit të vet të veprimit, atëherë

për ta kryer këtë proces, ajo patjetër duhet të ketë një marrëveshje. Është një marrëveshje vullnetare, për shkak se është një marrëveshje që ofrohet nga subjektet, nuk është një marrëveshje që del në tender.

Për shembull, kam për të bërë këtë edhe atë gjë dhe do dal në tender, por sipas një marrëveshjeje, dikush mund të ofrojë një situatë të kësaj çështjeje dhe fitimet e tij t'i gjejë mbi kursimet e energjisë dhe jo mbi dhënien e një tenderi të caktuar, prandaj janë quajtur marrëveshje vullnetare, në këtë kuptim. Por, sigurisht që çdo marrëveshje ka edhe sanksionet përkatëse, për arsye se sanksionet i merr konsumatori i madh, nuk i merr ai që bën marrëveshjen.

Ilir Beqaj – Ose nuk e dëgjon, ose nuk e kupton pyetjen.

Gjergji Simaku – Unë e kuptova pyetjen, por bëra diskutimin e gjerë për këtë çështje. Janë marrëveshje paraprake ose marrëveshje të paravendosura, ose modele marrëveshje, një pjesë e agjencisë dhe e konsumatorëve të mëdhenj të agjencisë, por mund të jenë edhe biznese të vogla e të tjera. Pra, është një marrëveshje *template* ose model.

Ilir Beqaj – Edhe një herë. Këto i kuptojmë, por nga pikëpamja e saktësisë. Te ligji flasim për marrëveshje, te pika 2/d për kontratë. Nuk po themi pse duhet, por si do ta saktësojmë instrumentin juridik, aktin juridik?

Gjergji Simaku – Nëse këto marrëveshje i bën agjencia, agjencia deri në këtë moment ka të drejtë të bëjë modelin e marrëveshjes, por jo vetë marrëveshjen, sepse duhet të jetë palë në një marrëveshje dhe duhet të ketë një kontratë.

Ilir Beqaj – Marrëveshja, midis kujt dhe kujt lidhet?

Gjergji Simaku – Marrëveshja lidhet midis konsumatorëve të mëdhenj të energjisë dhe është një marrëveshje e dakordësuar.

Ilir Beqaj – Cilët janë palët?

Gjergji Simaku – Është agjencia nga njëra anë që vendos gjoba dhe sanksione, për këtë krah, sepse kur agjencia vendos sanksione, do të thotë që konsumatori i madh, nuk ka marrë masat përkatëse për bërë dhe për këtë arsye i ofron një marrëveshje. Agjencia i thotë që mund ta bësh këtë gjë, nëpërmjet kësaj marrëveshjeje tip që kam unë dhe ai pastaj të gjejë të drejtën se me kë do ta kryejë këtë funksion, pra reduktimin e konsumit të energjisë ose investimet që kanë të bëjnë me vetë konsumatorin e madh. Kjo, sepse ka konsumatorë të mëdhenj që nuk e kanë në planet e tyre të kursejnë energji dhe është pikërisht marrëveshja që ofron agjencia me konsumatorët e mëdhenj, e cila ekzekutohet mes palëve që ofrojnë projekte, si të thuash....

Ilir Beqaj – Atëherë, është treshe marrëveshja?

Gjergji Simaku – Jo, agjencia shtyn bërjen e një marrëveshjeje dhe ua ofron këtë konsumatorëve të mëdhenj. Konsumatorët e mëdhenj duhet të gjejnë kompaninë e shërbimeve energjetike, që është më poshtë, për të bërë këtë marrëveshje të madhe,

Ilir Beqaj – Atëherë, çfarë bën agjencia, ofron modelin e marrëveshjes?

Gjergji Simaku – Po, ofron modelin e marrëveshjes.

Ilir Beqaj – Po, pastaj, për kë kontratë është fjala në pikën 2/d?

Gjergji Simaku – Në pikën 2/d, çështja e kontratës lidhet me shërbimet energjetike. Pra, marrëveshja është njëra anë, është marrëveshje vullnetare që ofrohet për konsumatorët e mëdhenj dhe në anën tjetër, vetë konsumatori i madh lidhet përmes një kontrate me kompanitë ESCO, me kompanitë e shërbimeve energjetike. Ky është shpjegimi për këtë nen.

Ilir Beqaj – Atëherë, kjo nuk është qartë fare.

Gjergji Simaku – Po kështu e ka direktiva *volunteer agreement*.

Ilir Beqaj – Unë nuk e kam me përkufizimin e nenit, por me mënyrën sesi vjen i shtjelluar.

“Marrëveshjet vullnetare, janë marrëveshje ndërmjet, (s’ka nevojë të jetë të dakordësuara) agjencisë dhe konsumatorëve të mëdhenj të energjisë”. Pra, agjencia jep modelin.

Zoti Simaku, ju lutem.

Gjergji Simaku – Po.

Ilir Beqaj – Pra, “marrëveshjet vullnetare janë marrëveshjet që lidhen ndërmjet konsumatorëve të mëdhenj të energjisë, bizneseve e të tjera dhe...”

Gjergji Simaku – Kompanive të shërbimit të energjisë.

Ilir Beqaj – Për të mbështetur e të tjera, “sipas modelit të miratuar nga agjencia”.

Gjergji Simami – “Nga agjencia përgjegjëse për eficiencën e energjisë”. Ekzakt.

Ilir Beqaj – Dakord. Si quhen ato kompanitë e shërbimeve?

Gjergji Simaku – Kompanitë e shërbimeve energjetike.

Ilir Beqaj – Kush është dakord me riformulimin që i bëmë nenit 9, i cili ndryshon nenin 12? Abstenim? Zoti Gjuzi. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 10. Pra, në nenin 10 që ndryshon nenin 13 nuk kemi gjë. Kush është dakord? Abstenim? Gjuzi dhe Shtjefni. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 11. Kush është dakord? Abstenim? Shtjefni dhe Gjuzi. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 12. Kush është dakord? Abstenim? Shtjefni dhe Gjuzi. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 13. Atëherë, për nenin 13 kemi vetëm këtë gjë që, pjesën e fundit të fjalisë “i cili miratohet 6 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji”, ta heqim prej këtu, sepse kemi rënë dakord që do të vendosim një nen për të gjitha hyrjet në fuqi.

Gjergji Simaku – Dakord.

Ilir Beqaj – Atëherë, kush është dakord me nenin 13, me këtë që sapo thamë? Abstenim? Zoti Gjuzi. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 14. Kush është dakord? Abstenim? Zoti Gjuzi. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 15. Kam një pyetje. “Audituesit energjitikë”, kush ua jep këtë titull, nga e marrin?

Gjergji Simaku – Atëherë, deri më sot, prandaj janë bërë edhe ndryshimet përkatëse, këtë titull ua jepte Agjencia për Efeciencë e Energjisë, përmes një certifikate të fituar në kurset e auditimit të energjisë dhe kështu është lënë deri tani, por me këto ndërhyrje që kemi bërë në ligj, kjo situatë do të përmirësohet me një vendim të Këshillit të Ministrave. Pra, nuk do të jetë veç agjencia që të nxjerrë procedura për certifikimin e audituesëve dhe ndërkohë vetë VKM-ja e ardhshme do të certifikojë edhe audituesit e huaj, sepse ne kemi pasur më parë..

Ilir Beqaj – Më fal.

Gjergji Simaku – Më thuaj.

Ilir Beqaj - Në qoftë se unë jam një subjekt i huaj, do të dalë me VKM që unë të certifikohem?

Gjergji Simaku - Jo, duhet ta kesh të akredituar këtë certifikim, në përputhje me legjislacionin tonë dhe në këtë pikë ne jemi lodhur goxha me konsulentët, për të parë sesi ishin modelet në vendet e tjera. Pra, në Itali është e ndryshme dhe ka disa trupa certifikuese, kurse në Shqipëri ka vetëm një trupë certifikuese që është Agjencia për Eficiencën e Energjisë dhe është normale. Tani, çështja qëndron që një auditues i certifikuar, por edhe një auditues, i cili ka kryer një master për auditues energjie në universitet, atëherë pse duhet ta rifusim në procesin e testimit. Kjo është, pak a shumë, logjika që është bërë për audituesit e energjisë. Kështu që, i lihet e drejta Këshillit të Ministrave të vendosë një procedurë të qartë dhe transparente për këtë çështje, që certifikimi të jetë një proces i zakonshëm.

Pra, kush e meriton, ta marrë mbi bazën e një kurrikule apo mbi bazën e disa moduleve të vendosura, të cilat me futjen e këtij ligji do të ndryshojnë, sepse ndryshojnë edhe siç e shikoni më sipër ndryshojnë audituesit energjikë për 3 kategori kryesore, për ndërtesat, për sipërmarrjet industriale

Ilir Beqaj – Ta bëjmë “objekte industriale” këtë, jo “sipërmarrje”

Gjergji Simaku – Pra, për objekte industriale dhe për sektorin e transportit. Pra, tani shfaqen 3 lloje auditues, futet edhe sektori i transportit, i cili lidhet posaçërisht me dioksidin e karbonit, pra me gazet serë dhe pa u audituar ti nuk mund të ndërhysh në proceset e transportit për këtë çështje, siç janë transporti publik.

Ilir Beqaj – Kush do ma japë mua certifikatën, në qoftë se dua të aplikoj?

Gjergji Simaku – Atëherë, që të marrësh certifikatën duhet të kryesh një kurs.

Ilir Beqaj – Kush do ma japë, nuk kanë rëndësi kriteret?

Gjergji Simaku – Agjencia për Eficiencën e Energjisë do ta japë, sipas një vendim të Këshillit të Ministrave, me atë procedurë.

Ilir Beqaj – Jo, një sekondë, se këtu më ngatërron.

VKM-ja do të përcaktojë procedurën apo certifikatën nominale timen?

Gjergji Simaku – Do përcaktojë procedurën.

Ilir Beqaj – Po, pra procedurën atëherë, se është tjetër gjë të përcaktojë procedurën.

Gjergji Simaku – VKM-ja e tanishme përcaktonte se kush do ta jepte dhe ne po në atë drejtim kemi shkuar, por kjo VKM e re, do të jetë edhe duke futur edhe vetë procedurat, deri më sot procedurat e marrjes së certifikatës i bën agjencia. Kjo nuk do t'i lihet më agjencisë, por qartësohet në vendim.

Ilir Beqaj - Atëherë, në pikën 1, tek ekzistuesja, e keni pasur më të qartë. Do ta ritheksojmë edhe një herë pikën 1 dhe pastaj do ta hapim rrugën që me VKM të miratohen procedurat.

Dakord?

Gjergji Simaku – Dakord.

Ilir Beqaj - Kush është dakord me nenin 15 me këto ndryshime që thamë, përfshirë edhe ndryshimet e shprehjes “sipërmarrjet industriale” në “objekte industriale”? Abstenim? Shtjefni. Kundër nuk ka.

Miratohet.

Neni 16.

Shoqëritë energjetike kush i certifikon?

Gjergji Simaku – Shoqëritë energjetike nuk certifikohen, por është një model. Sipas udhëzimit të ministrit dhe sipas një propozimi të Agjencisë për Eficiencën e Energjisë, është llojet e shërbimeve energjetike, të cilat do të shkojnë në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Arsyetimi i drejtuesit teknik të këtyre shoqërive do të jetë një auditues i certifikuar. Kjo është lënë e tillë, sepse ne kemi pasur problematika që agjencia nuk mund të marrë shoqëri për t'i testuar dhe për t'ju dhënë pastaj të drejtën për të kryer shërbime energjetike.

Ilir Beqaj – Do ta bëj QKB-ja automatikisht?

Gjergji Simaku – Automatikisht, por me drejtues teknik auditues të certifikuar.

Ilir Beqaj – Certifikimin kush e bën?

Gjergji Simaku – “Dhe të certifikuara në përputhje me legjislacionin në fuqi”. Fjalja që vjen pas e tregon këtë gjë.

Ilir Beqaj – Jo, të zgjidhim fjalinë e parë njëherë.

Gjergji Simaku – Fjalja “certifikuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit” nuk qëndron, por qëndron pjesa tjetër. Drejtuesi teknik është auditues i certifikuar.

Ilir Beqaj – Ne mund të themi, “të cilat janë regjistruar në QKB”. Në qoftë se pjesa tjetër është e tepërt, vazhdojmë me drejtuesin teknik.

Gjergji Simaku – Ekzakt. Askush nuk certifikon.

Ilir Beqaj - Dakord. Këtë duhet të themi.

Vazhdojmë me pikën 2.

“Shërbimet energjetike ofrohen në përgjithësi”. Pse në përgjithësi dhe jo veçanti? Mos është e tepërt fjala “në përgjithësi”?

Gjergji Simaku – “Ofrohen mbi bazën e kontraktimit”. Mund ta heqim fjalën “në përgjithësi”.

Ilir Beqaj – Dakord.

Gjergji Simaku - Dolëm te modeli i kontratës, që kishim të marrëveshja me ...

Ilir Beqaj – Këtu thuhet, në pikën 3, germa “gj”...

Dispozita të qarta dhe transparente për matjen dhe verifikimin e kursimeve të garantuara ...*(nuk dëgjohet)*, kontrolli i cilësisë, garancitë”.

Gjergji Simaku – Këto janë pjesë e kontratës së performancës.

Ilir Beqaj – Këto pjesët e kontratës pse duhet t'i ketë ligji? ... i kontratës miratohet me udhëzim ministri. Si mendoni, kolegë?

Gjergji Simaku – Për mendimin tim, e shkurtojmë.

Ilir Beqaj – Ky është ligj, nuk është manual.

Kontratë e performancës së energjisë miratohet me udhëzim të ministrit në bazë të propozimeve të Agjencisë për Eficiencën e Energjisë.

Gjergji Simaku – Faktikisht, ky ishte një diskutim me konsulentët për shkakun se e përmban direktiva. Këto janë parimet e kontratës, të cilat duhet të jenë detyrimisht. ...

Ilir Beqaj – E bëjmë me aktet nënligjore dhe e zgjidhim kështu.

Kush është dakord me ndryshimin që bëme fillimisht te pika 1, ku hoqëm shprehjen “të certifikuar në përputhje me legjislacionin në fuqi për eficiencën”, te pika 2 hoqëm fjalën “në përgjithësi” dhe te 3 bëme vetëm fjalinë gjenerike pa detajet me germat?

Për pikën 4 na ka sjellë Komisioni i Integritimit riformulim për germën “b”. Ju jeni njohur me ndryshimin që ka bërë Komisioni i Integritimit?

Gjergji Simaku – Jo për këtë pjesë. Cili është ndryshimi?

Laureta Dibra – Kemi rënë dakord. Lista e përditësuar të ofruesve të kualifikuar/certifikuar për shërbime energjetike, shoqëruar me dokumentacionin përkatës mbi kualifikimin ... *(nuk kuptohet)*.

Gjergji Simaku – Nuk është e rëndësishme atëherë.

Ilir Beqaj – Ka sugjeruar edhe shtimin e germës “ç”. Jemi dakord edhe me të?

Gjergji Simaku – Dakord.

Ilir Beqaj – Pika 5.

Për çfarë ju duhet të jetë në ligj. Nuk ka asgjë. Është shumë e përgjithshme.

“Agjencia siguron një shqyrtim cilësor”. Për çfarë duhet të jetë? Është apo jo në ligj, çfarë ndryshon? Se si e bën punën agjencia që siguron shqyrtim cilësor? Agjencia ka një procedurë se si është krijuar. Unë mendoj se pika 5 nuk duhet të jetë në ligj.

Gjergji Simaku – Dakord. Për shkakun se agjencia bën një raport për ministrin, i cili raporton në Këshillin e Ministrave për gjendjen e eficiencës së energjisë. E ka detyrë funksionale.

Ilir Beqaj - Siguron një shqyrtim cilësor lidhur me zhvillimin aktual.

Kush është dakord me nenin 16, me ndryshimet që bëme në pikat 1, 2 dhe 3, me propozimet e Komisionit të Integritimit për pikën 4, me shtesën që ka bërë për 4/ç dhe me heqjen e pikës 5? Abstenim? Nuk ka. Kundër nuk ka.

Miratohet.

Neni 17.

Në pikën 4 ...

E para, themi “operatorët”, jo “operatori”, sepse OST-ja dhe OSHEE-ja janë të ndryshme.

Gjergji Simaku – Po, janë të ndryshme.

Ilir Beqaj - “Marrin masa për vendosjen apo për përdorimin e matësve”, sepse zbatimi matësve është një gjë pak ...”. Për vendosjen dhe përdorimin, besoj. Apo jo?

Gjergji Simaku – Për vendosjen dhe përdorimin e matësve inteligjentë. Kjo është një çështje afatgjate.

Ilir Beqaj – Fjala “zbatim matësish” na duket pak e vështirë.

Gjergji Simaku – E drejtë.

Ilir Beqaj – Dakord.

Hedhim në votim nenin 17 me këto që thamë?

Kush është dakord? Abstenim? Shtjefni dhe Gjuzi. Kundër nuk ka.

Miratohet.

Neni 18.

Kush është dakord? Abstenim? Shtjefni dhe Gjuzi.

Miratohet.

Neni 19.

Kush është dakord? Abstenim? Shtjefni dhe Gjuzi.

Miratohet.

Neni 20.

Kush është dakord? Abstenim? Shtjefni dhe Gjuzi.

Miratohet.

Neni 21.

Kam një pyetje zoti Simaku. Në fund të fjalisë thoni “të ministrit përgjegjës për Energjinë dhe kredencialet e personit”. Çfarë do të thotë kredencialet e personit?

Gjergji Simaku – Në cilin nen jeni?

Ilir Beqaj – Neni 21, pika 3, shtohet pika 3 dhe 4 me këtë përmbajtje: “Për energjinë dhe kredencialet e personit të punësuar si menaxher energjie”. Kredencialet çfarë janë.

Gjergji Simaku – Kredencialet e personit të punësuar si menaxher energjie janë të gjithë menaxherët e energjisë të emërtuar nga konsumatori i madh. Konsumatori i madh ka detyrimin të emërtojë një ...

Ilir Beqaj - Zoti Simaku, cilat janë kredencialet e Ilir Beqajt, nëse do të kishte këtë funksion?

Gjergji Simaku – E drejta që ai të kishte një certifikatë menaxheri energjie. Nuk mund të jetë kushdo përveçse atij.

Ilir Beqaj – e Kuptoj, por termi “kredenciale” është ...

Gjergji Simaku – Unë mendoj të themi personit të certifikuar si menaxher energjie.

Ilir Beqaj – Atëherë nuk ka nevojë për fjalën “kredencialet”

Zonja Laureta keni ju një opinion?

Laureta Dibra – Doja të thosha që mund ta themi “të dhënat e personit të punësuar si menaxher energjie”.

Ilir Beqaj – Kur themi personin, ai ka edhe të dhëna.

E hoqëm fjalën “kredencialet”

Pika 4. Unë këtu kam një shqetësim zoti Simaku, të cilin e ngriti pak edhe zonja Gjermani.

Ne po kalojmë një situatë jo të lehtë ekonomike të vendit dhe subjekte të ndryshme kanë vështirësitë e tyre. Në fund të fundit të marrësh certifikatën ISO brenda 6 muajve është edhe një kosto. Mund ta bëjmë 12 muaj?

Laureta Dibra – Ideja është që, nëse ai e ka nxjerrë këtë certifikatë, mund ta dorëzojë brenda 6 muajve. Dorëzimi nga momenti i marrjes së certifikatës të jetë 6 muaj.

Ilir Beqaj – Dakord. Kush e ka, ta dorëzojë.

Laureta Dibra – Po. Kurse procesi i certifikimit zgjat 2-3 vjet.

Ilir Beqaj – Dakord.

Kush është dakord me nenin 21, me heqjen e termit “kredencialet”? Personi i punësuar menaxher energjie është patjetër me certifikatë.

Xhilda Pinci – “Sipas formatit të miratuar me udhëzim të ministrit përgjegjës për Energjinë dhe personit të punësuar si menaxher energjie”.

Ilir Beqaj – Po. “dhe personin”. Pra, “kredencialet e personit” zëvendësohen “me personin”. Duhet të dërgojnë kush është personi dhe ...

Xhilda Pinci – Kam përshtypjen që këta certifikohen menaxherë të energjisë.

Ilir Beqaj – Të dhënat e personit ose personin. Atëherë, “të dhënat e personit”, siç e tha edhe zonja Laureta.

Neni 22.

Kush është dakord? Abstenim? Shtjefni dhe Gjuzi besoj. Kundër nuk ka.

Miratohet.

Komisioni ynë propozon që pas nenit 22 të shtohet neni 22/1, ku të evidentojmë me radhë të gjitha aktet nënligjore që duhet të dalin nga Këshilli i Ministrave apo nga ministri.

Kush është dakord.

(Nuk dëgjohet)

Në fakt, ti ato i vendos si kritere dhe në qoftë se ai nuk plotëson kriteret nuk hyn te lista ekonomike.

E zgjidhim kështu nenin 5? Kush është dakord? Abstenim? Shtjefni dhe Gjuzi. Kundër nuk ka.

Miratohet.

Hedhim në votim ligjin në tërësi.

Kush është dakord? Abstenim? Gjuzi. Kundër nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit, kolegë!

Përgëzime përfaqësuesit të ministrisë!

Sfida është ta zbatojmë dhe të mos vijmë përsëri me shtyrje afatesh. Për mbledhjen e ardhshme do t'ju njoftojmë.

Ditë të mbarë!

Gjergji Simaku – Faleminderit dhe ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA